

Komuna e Rahovecit 2017: Problemet kryesore dhe trendet buxhetore

Hyrje

Rahoveci udhëhiqet nga Idriz Vehapi i cili përfaqëson Partinë Demokratike të Kosovës. Ky është mandati i tij i parë.

Në zgjedhjet e fundit për kryetar të komunës (nëntor 2013) Idriz Vehapi ka fituar në balotazh kundrejt kandidatit nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës Smajl Latifi. Ky i fundit në raundin e parë ka siguruar 8,169 vota (apo 33%), ndërsa Vehapi ka pasur 9,609 vota (apo 39%). Në balotazh, Vehapi ka siguruar 11,890 vota (53%) ndërsa Latifi ka marr 10,810 vota (47%).¹

Hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal dhe kryesisht i dinë mundësitë buxhetore e ligjore që ka një komunë.² Sipas një studimi të UNDP-së, 85% e qytetarëve të Rahovecit konsiderojnë se komuna mund t'i zgjidhë problemet me të cilat ballafaqohen ata.³ Dy vite pas nisjes së mandatit të kryetarit Vehapi, vetëm 41% e qytetarëve janë shprehur të kënaqur me punën e tij, përderisa vetëm 28% e qytetarëve kanë konsideruar se fondet publike në komunë menaxhohen siç duhet.⁴

¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rezultatet për Kryetarë Komune 2013. Burimi: <http://bit.ly/1d30foS> (Hapur më 18 qershor 2017) Rezultatet për Balotazh. Burim: <http://bit.ly/2szzr1OU> (Qasur me 18.06.2017)

² Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësisë: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2os7GPU> (Qasur me 18.06.2017)

³ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

⁴ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 91 & 92. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

Në prag të zgjedhjeve lokale 2013, Instituti GAP kishte identifikuar problemet kryesore të Komunës së Rahovecit. Ndër problemet më madhore kishin dalë të jenë: mungesa e ujit të pijes, mungesa e kanalizimeve, problemi nga pickimi i rriqrave, problemi i përroit në Xerxë si dhe dëmtimi shtretërve të lumenjve.⁵

Problemet aktuale të Komunës së Rahovecit

Numri i madh i mungesave të nxënësve në orët e mësimi: Komuna e Rahovecit ka gjithsej 42 objekte shkollore. Gjatë një viti, numri i nxënësve gjithsej në shkolla fillore dhe ato të mesme është rreth 12,000 nxënës. Gjatë viteve të fundit, në shkolla është paraqitur si problem numri i madh i mungesave të nxënësve. Në vitin 2016 (gjatë semestrit të parë dhe të dytë), Drejtoria e Arsimit e kësaj komune, ka evidentuar 208,903 mungesa të nxënësve në orë mësimore.⁶

Mungesa e kabineteve në shkollat profesionale: Komuna e Rahovecit ka një shkollë profesionale dhe aty mësimin e ndjekin rreth 400 nxënës. Shkolla është në objekt të ri, por mungojnë kabinetet përkatëse për mësim praktik nga nxënësit. Kur ka nisur ndërtimi i shkollës ka qene e parapare që objekti të ketë kabinetin e teknologjisë së ushqimit, teknologjisë informative, kabinetin e elektros, makinerisë dhe bujqësisë. Asnjërin nga këto kabinete nuk i ka kjo shkollë.

Mungesa e ndriçimit publik dhe mos funksionimi i tij: Pjesa dërmuese e fshatrave të Rahovecit nuk kanë sistem të ndriçimit publik. Ndërsa në brendi të qytetit janë të shpeshta që sistemi i ndriçimit publik nuk funksionin. Kjo është e shfaqur veçmas në zonën nga lagja Rahoveci nr. 1, rruga nga udhëkryqi "Halil Hamza" pastaj rruga "Gëzim Hamza – Piktori" e deri tek pompa AL – Petrol, pastaj rruga "Mustaf Ibishi", "Dëshmorët e Pashtrikut" dhe rruga "Mexhit Mustafa".

Mungesa institucionale në bartjen e nxënësve me nevoja të veçanta: Në komunën e Rahovecit ekziston një shoqatë "Hareja" e cila përkujdeset për fëmijët me nevoja të veçanta. Kjo qendër kujdeset që gjithë fëmijët e kësaj kategorie duke përfshirë edhe në fshatrat e thella të sillen në qendër me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme. Në disa raste, bartja e këtyre fëmijëve ka qenë e pamundur shkaku i

⁵ Instituti GAP. Problemet Kryesore dhe trendet buxhetore të Komunës së Rahovecit 2013. Burim: <http://bit.ly/2rUVfhT> (Qasur me 18.05.2017)

⁶ Problemet nëpër komuna janë listuar bazuar në intervista të drejtpërdrejta me përfaqësues komunal, të partive politike, shoqërisë civile, mediave dhe njohëseve të qeverisjes lokale.

mungesës së transportit. Komuna ka ndarë subvencione për ketë shoqatë, por nuk kanë qenë të mjaftueshme në përmbushjen e misionit.

Mungesa e rrjetit të ujësjellësve: Pjesa më e madhe e fshatrave të komunës së Rahovecit nuk kanë rrjet të ujësjellësit. Zgjidhja nga banorët bëhet përmes hapjes së puseve të ujit ose bartjes së ujit nga një vendbanim në vendbanimin tjetër. Rrjeti i ujësjellësit mungon në rajonin e fshatrave të Guri i Kuq, Palluzha, Kazniku, Pastaseli, Mrasori dhe fshati Retij.

Mungesa e ujit të pijes në qytet: Zona në lagjen 3 të Rahovecit ka rrjet të ujësjellësit, por nuk ka ujë të pijes. Ky problem është ngritur nga ana e tyre përmes një peticioni të banorëve, por edhe nga organizimi i dy protestave ku është kërkuar adresimi i këtij problemi nga ana e autoriteteve.

Mungesa e kanalizimeve: Rrjeti i kanalizimit mungon edhe në disa lagje të qytetit sikurse në lagjen "Stana". Problemi është më i theksuar në zonat rurale. Vlerësimet e bëra nga autoritetet komunale flasin se në 70% të fshatrave të Rahovecit mungon rrjeti i kanalizimit.

Probleme nga ujërat atmosferik (vërshimi i tokave bujqësore): Mungesa e kanalizimeve ose mungesa e ndërtimit të përroskave përkatëse ka bërë që shumë vendbanime të Rahovecit të paraqesin si problem vërshimet, ose ujërat atmosferikë. Ky problem është më i shfaqur në Qifllak, Dabidol, Fortesë, Malësi të Vogël, Gexhe, Pastasel, Reti, Hoqë të Vogël, dhe në fshatin Celin.

Mos zgjidhja e pronësisë së stacionit të autobusëve: Komuna e Rahovecit e ka të trashëguar stacionin e autobusëve. Pronësia e tij akoma është e pazgjidhur. Juridikisht i takon Agjencisë Kosovare të Privatizimit, por teknikisht mirëmbahet nga ana e komunës. Komuna nuk ka bërë ndonjë hap në zgjidhjen e statusit të kësaj kompanie.

Rreziku nga objektet e vjetërsuara: Komuna e Rahovecit ka një numër relativisht të madh të objekteve në pjesët e ndryshme të qytetit të cilat janë të vjetërsuara dhe paraqesin rrezik nga shembja duke kanosur sigurinë e qytetarëve. Komuna deri tani nuk ka ndërmarrë ndonjë masë mbrojtëse për riparimin ose konservimin e këtyre objekteve.

Mungesa e çerdheve për fëmijë: Në komunë të Rahovecit janë të deponuara tri kërkesa të banorëve për hapje të çerdheve. Një është nga fshati Krushë e Madhe, nga fshati Ratkoc dhe një nga fshati Xërxë. Deri tani komuna nuk ka futur në buxhet ose në planet e saj hapjen e çerdheve të reja.

Fushave që komuna duhet t'u kushtojë vëmendje

Rregullimi i një shëtitore për qytetarët

Komuna e Rahovecit duhet të nis investimet në disa projekte të cilat do të bënin me tërheqës qytetin veçmas në qendër. Akoma komuna nuk ka ndonjë shesh apo së paku shëtitore në formë të bulevardit ku do të mund të dilnin qytetarët. Komuna duhet t'u kushtojë vëmendje këtyre investimeve në katër vitet e ardhshme.

Shtrirja e festivalit të rrushit edhe në qytetet e tjera


Komuna e Rahovecit duhet të shohë mundësinë që të hyjë në marrëveshje mirëkuptimi me komunat e tjera me qëllim të organizimit të festivalit të rrushit edhe jashtë komunës së Rahovecit. Kjo do të ndikonte pozitivisht të vreshtarët e kësaj komune, por edhe njëkohësisht do të mundësonte gjithë qytetarëve pjesëmarrjen në aktivitete të tilla të cilat aq sa janë kreative janë edhe profitabile.

Trendet buxhetore në Komunën e Rahovecit (2017)

Komuna e Rahovecit në vitin 2017 ka planifikuar 11.9 milion euro buxhet.⁷ Përveç planifikimeve të rregullta, Komuna e Rahovecit ka bartur edhe rreth 210 mijë euro nga të hyrat vetanake e vitit të kaluar, ndërsa në vitin 2013 ishin bartur rreth 194 mijë euro. Krahasuar me vitin 2013, Komuna e Rahovecit ka pasur një rritje afro 2 milion euro të buxhetit. Krahasuar buxhetin e vitit 2017 me kohën e zgjedhjeve të fundit (2013), rritja e buxhetit është bërë në kategorinë e pagave, por ka pasur rritje të vogël të buxhetit në investime kapitale. Kësisoj për paga në 2013 janë ndarë 5.4 milionë euro (55% e buxhetit), përderisa në 2017 ky buxhet është për rreth 1.7 milionë euro me i lartë (72% e buxhetit të ndarë), ndërsa në kategorinë e investimeve kapitale në 2013 Rahoveci ka ndarë 3.3 milionë euro (34%) ndërsa në 2017 në 3.7 milionë euro (38%).


⁷ Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2rMELbD>

Figura nr.1: Buxheti i Komunës së Rahovecit 2017




Komuna e Rahovecit vazhdimisht ka pasur një dominim të shpenzimeve në paga dhe trendi ka shkuar në rritje, përderisa investimet kapitale kanë pasur lëvizje të ndryshme, kryesisht gjatë viteve të fundit është shënuar rritje simbolike.

Figura nr.2: Trendët buxhetore të Rahovecit 2013-2017



Komuna e Rahovecit gjatë vitit 2016 ka pasur rritje të hyrash vetanake komunale. Krahasuar me vitin 2013, K. e Rahovecit ka realizuar rreth 160 mijë euro më shumë të hyra vetanake në vitin 2016.

Figura nr.3: Të hyrat komunale 2013- 2017



Rekomandime

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerr këto veprime:

- Komuna duhet të ketë takime më të shpeshta me këshillat e prindërve me qëllim të gjetjes së mënyrave për të shmangur numrin e madh të mungesave të nxënësve në orët e mësimi.
- Komuna duhet të sigurojë kabinete përkatëse për gjitha shkollat profesionale të kësaj komune.
- Komuna duhet t'i rris fondet për të zgjeruar ndriçimin publik.
- Komuna duhet të sigurojë bartjen e fëmijëve me nevoja të veçanta.
- Komuna duhet të gjejë burime uji për të siguruar ujin e pijes në qytet dhe zona përreth.
- Komuna duhet të nis pastrimin e lumenjve dhe shmangien e vërshimit të tokave bujqësore.
- Komuna duhet të nis grumbullimin e një fondi lokal për mbulimin e dëmeve të vreshtarëve në raste të ndryshme natyrore.
- Komuna duhet të ndërtojë çerdhe në qytet.
- Komuna duhet në partneritet me komunat e tjera të mundësoj daljen e festivalit të rrushit edhe jashtë Rahovecit.

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world